

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Isa Kelmendi kryetar, Shukri Sylejmani dhe Emine Kaçiku anëtarë, në çështjen juridike të paditësit “M.-H.” sh.p.k & NNSH “K.” me seli në ... të cilën e përfaqëson B. L. avokat nga ..., kundër të paditurit Qeveria e Republikës së Kosovës- Ministria e Administratës Publike me seli në Prishtinë, për shkak të borxhit duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës të paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AE.nr.196/2016 datë 13.12.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 15.04.2019 morri këtë :

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës– Ministria Administratës Publike me seli në Prishtinë, paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës AE.nr.196/2016 datë 13.12.2018.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës AE.nr.196/2016 datë 13.12.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria Administratës Publike me seli në Prishtinë, dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Ekonomike III. C.nr.261/2013 datë 02.02.2016 me të cilin nën pikën I të dispozitivit është aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “M.-H.” sh.p.k. & NNSH “ K.” me seli në ..., dhe është detyruar e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria Administratës Publike me seli në Prishtinë që paditëses “M.-H.” sh.p.k. & NNSH “ K.” me seli në ..., ti paguaj borxhin kryesor në shumë prej 58.640,00 € së bashku me kamatën të cilën e paguajnë Bankat Vendore si për mjetet e deponuara në kursim me afat mbi një vit e pa destinim të caktuar duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë 27.05.2013 e deri në pagesën definitive të gjitha në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përbarimit me detyrim. Nën pikën II të dispozitivit detyrohet e paditura që paditëses t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës civile në shumë të përgjithshme prej 3.024.00 € në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të aktgjyimit.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura në afat ligjor ka ushtruar revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovoj revizionin si të bazuar dhe të anuloj aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës AE.nr.196/2016 datë 13.12.2018 dhe atë gjykatës së shkallës së parë dhe lenden t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Paditësi në përgjigje në revizion thekson se nuk qëndrojnë pretendimet nga revizionin dhe propozon që i njëjti të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e goditur dhe pretendimet e revizionit dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 215 të LPK-së, gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Në procedurën e zhvilluar e cila i ka paraprirë marrjes e aktgjykimit të goditur është vërtetuar se në mes të palëve ndërgjyqëse në procedurë ka ekzistuar një marrëdhënie kontraktuale në bazë të kontratave nr..., dhe ..., me numër të identifikimit ..., datës ... si dhe nga aneksi kontrata e datës ..., për ndërtimin e dy Objekteve Ndërtimore një në Pejë dhe një në Prizren, ku paditësi është punë kryerës. Në këto kontrata janë precizuar kushtet e përgjithshme dhe ato të veçanta e njëherit janë përcaktuar parametrat dhe për masat e punës kryere dhe para llogaria sipas situacioneve për punë të kryera. Po ashtu është paraparë edhe afati për kryerje të punimeve. Sipas ekspertizës të ekspertit të ndërtimtarisë rezulton se kontrata nuk është përmbush në tersi pasi që punë kryerësi ka pasur vështirësi dhe shumë pengesa në realizimin e kontratave. Eksperti në mendimin e vet gjen se qysh në fillim të ndërtimit të Objekteve ka pasur ndryshime të mëdha sa i përket projektit dhe lokacionit që duhet ndërtuar objektet e si pasoj kanë rrjedhë punët e tepërta, punë të pa parapara dhe punë shtesë e që punë kryerësi ka pasur shpenzime shtesë dhe të pa parashikueshme, gjithashtu autoriteti kontraktues nuk i është përmbajtur nenit 36.3 dhe 36.4 të kontratës. Nga këto arsye ka ardhur deri te shkëputja e kontratës në mënyrë të një anshme pa marrëveshje të kontraktuesve. Prandaj me datë 09.09.2013 autoriteti kontraktues benë prerjen e punimeve të kryera. Sipas prerjes së bërë për punët e kryera punë kryerësit për punët e kryera sipas mendimit të ekspertit duhet paguar për Pejë 32.441.00 € ndërsa për Prizren 26.199.00 € apo gjithsej për të dy objektet shumen e tërësishme prej 58.640.00 €.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes gjykata e shkallës së parë e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj kundër vlerën për punët të kryera duke u bazuar në mendimin e ekspertit të ndërtimtarisë, për kundër faktit se ka ardhur gjeri të shkëputja e një anshme e

kontratës dhe se autoriteti kontraktues ka angazhuar një kontraktues tjetër për përfundimin e punimeve. Prandaj ka vendosur me afërsisht e përshtuar si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka pranuar si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar nga se aktgjykimi i ankimuarë përmban arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante për gjykim të drejt të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, prandaj ka refuzuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes pranon në tersi si të drejt dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët nga se në gjendjen faktike të vërtetuar drejt, drejtë janë aplikuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe e drejta materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar. Kjo nga se aktgjykimet e lartpërmendura përmbajnë arsye të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshëm për gjykim të drejtë të kësaj çështje juridike të cilat arsye si të drejta dhe të plota i pranon edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 215 të LPK-së.

Në bazë të nenit 17 të LMD pjesëmarrësit e marrëdhënies e detyrimit kanë për detyrë të zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjëse për përmbushjen e detyrimit. Në rastin konkret në pyetje është kontrata për ndërtim e cila në kuptim të neni 630 të LMD duhet të lidhet në formë të shkruar. Mirëpo qysh prej fillimit të ndërtimit të objekteve ka pasur ndryshime në mes të projektit dhe lokacionit ku duhet ndërtuar objektet e si pasojë kanë rrjedhë punët e tepërta, punë të pa parapara dhe punë shtesë që për kryerësin ka pasur shpenzime shtesë dhe të pa parashikuara. Nga shkresat e lëndës dhe mendimit të ekspertit rezulton se kryerësi i punimeve e ka njoftuar porositësin për këto ndryshime dhe nevojën e kryerjes së punimeve shtesë për shkak të ndryshimeve në projekt dhe pozicione dhe këto punë janë kryer nën mbikëqyrjen e mbikëqyrësit të projektit të angazhuar nga vet porositësi, punët janë regjistruar në librin ndërtimor dhe nuk janë kundërshtuar nga mbikëqyrësi, andaj gjykata vlerëson se porositësi ka dhënë pëlqimin për këtë. Duke u bazuar në neni 634 Paragrafi 4 dhe 5 të LMD kjo gjykatë gjen se paditësit i takon e drejta e shpërblimit për punët e kryera për ndryshimet e punëve respektivisht punë shtesë të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në momentin e lidhjes së kontratës, por kanë rrjedhë si pasojë e ndryshimit të pozicioneve dhe të njëjtat janë evidentuar në ditarin e punës dhe nuk janë kundërshtuar nga organi mbikëqyrës. Prandaj edhe sipas qëndrimit të kësaj gjykate gjykatat e instancës më të ulët kanë vepruar drejt kur në kuptim të nenit 132 të

LMD-së, kanë detyruar të paditurën në kompensimin e punëve të kryera punë kryerësit gjer në momentin e shkëputjes së kontratës.

Gjykata Supreme e Kosovës i ka vlerësuar si të pa bazuar dhe irelevante thëniet e të paditurës në revizion se paditësi nuk i ka përmbushur detyrimet nga kontrata përkatësisht nuk i ka kryer në tersi punët e kontraktuar dhe se me neni 2.2 të kontratës është paraparë se çmimi i përcaktuar në paragrafin 2.1 në total do të jetë çmim i detyrueshëm për autoritetin kontraktues, për arsye se objekt i kontestit është kompensimi i pjesërisht për punët e kryera nga punë kryerësi e jo shuma totale për tërë objektet dhe as nuk ka qenë kontestues fakti se kanë mbetur disa punë të pa kryera pasi që ka ardhur deri te zgjidhja e kontratës në mënyrë të një anshme nga autoriteti kontraktuese. Prandaj këto pretendime paraqiten si irelevante për vendosje tjetër në këtë çështje juridike. Nga ana tjetër kjo gjykatë shton se sipas nenit 214.2 të Ligjit të procedurës kontestimore revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstaitmit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike, përderisa revizion në të vërtetë për këto arsye e godet aktgjykimet të gjykatave të instancës më të ulët duke potencuar se këto aktgjykime janë bazuar në vlerësim të gabueshëm të provave nga se nuk është ndriçuar fakti se a janë kryer apo jo punët kontraktuese në tersi.

Nga sa u tha më lartë Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se nuk ekzistojnë arsyet për të cilat është paraqitur revizioni dhe me zbatimin e nenit 222 të LPK-së, u vendosa si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

E.Rev.nr.10/2019 datë 15.04.2019

Kryetar i kolegjit

Isa Kelmendi